

## AKTI I THEMELIMIT

(Kontrata)

### PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TROPICAL TRAVEL & TOURS"

Në Tiranë, sot më datën, 08.02.2021 (Dy mije e njeze e nje), ne, personat fizikë me të dhënat e mëposhtme:

1) **MARIOGLEN XHUMARI**, i biri i Sali, i datëlindjes 31.01.1989, lindur në Lushnje dhe banuese ne Tirane, Rr. "Xhenfize Keko", Pallati Andi Konstruksion, Shk. 7 Kati 2 Hyrja 2 i pajisur me No. ID personal: **I90131018Q**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, dhe me profesion Ekonomist.

2) **VILMA ABIB**, e bija e Jorgji, e datëlindjes 05.05.1986, lindur në Kukës dhe banuese ne Tirane, Rr. "Ibrahim Buzhiqi", No. 99 Tirane, e pajisur me No. ID personal: **I65505128K**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me profesion Mesuesi.

me cilësinë e ortakëve themeluesë, krijojmë **Shoqërinë Turistike me Përgjegjësi të Kufizuar** në përputhje me Ligjin №. 9901, datë, 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi, me të dhënat që

**v i j o j n ë :**

#### Neni 1

1.1 Shoqërinë e krijojmë sipas llojit: - Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar.

#### Neni 2.

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është: Shoqëria "**TROPICAL TRAVEL & TOURS**" - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose shkurt: "Shoqëria "**TROPICAL TRAVEL & TOURS**" - SH.P.K." që, në mjaft raste, në dokumentet e krijimit të saj, do të shkruhet edhe më shkurt: "Shoqëria" ose "**TROPICAL TRAVEL & TOURS**".

2.2 Selia e Shoqërisë është: - Rruga "Mine Peza", Ap. 25, Godina 3/111+4-25 , Zona kadastrale nr .8350, Godina 3 , Hyrja 4 (Nr.14), Tirane, Republika e Shqipërisë.

#### Neni 3.

3.1 Shoqëria do të funksionojë për një periudhë kohe prej 10 (dhjetë) vjetësh, me të drejtë përsëritje.

#### Neni 4.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

- Ushtrim i veprimtarisë së lirë private në fushën e turizmit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Organizim i grupeve të ndryshme turistike vëndas dhe të huaj dhe kryerja e guidave turistike me ta brenda dhe jashtë vendit;
- Akomodimi i grupeve të ndryshme turistike në hotele, fshatra turistike, kampingje, shtëpi pushimi, restorante, etj.
- Shoqërim me/pa përkthyes dhe me/pa ciceronë i grupeve të ndryshme turistike në guidat e tyre brenda dhe jashtë vëndit;
- Agjensi për shitjen e biletave të udhëtimit për mjetet e transportit ajror, detar, hekurudhor dhe tokësor sipas marrëveshjeve të bëra me persona të ndryshëm fizikë dhe juridikë vëndas dhe të huaj në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Organizim dhe kryerje e shërbimit të ndërmjetësimit, të përfaqësimit dhe të komisionerisë me persona fizikë dhe juridikë vëndas dhe të huaj për kryerjen e veprimtarive të ndryshme turistike;
- Organizimi dhe kryerja e propagandës dhe reklamës turistike me mjetet e ndryshme të informacionit të lejuar;
- Organizim dhe kryerje e veprimtarive të ndryshme me turistë vëndas dhe të huaj, si: hipizëm, motoçiklizëm, gara makinash, biçikletash, etj.
- Organizim dhe kryerje e transportimit të turistëve vëndas dhe të huaj me mjete të ndryshme të transportit ajror, detar, hekurudhor dhe tokësor shtetëror apo privat, të vet shoqërisë apo të marra me qira (renta car) në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin e lejuar.
- Aplikim vizash
- Marketing Online
- Shërbim Pagesash
- Siguracione
- Shitje – Blerje mallrat e ndryshem

4.2 Shoqëria krijohet me qëllim që ne, themeluesit e saj të merremi me ushtrimin e veprimtarisë tonë të lirë private dhe, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të përfitojmë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, që pasqyrohet në Nenin 4.1 të këtij Akti.

4.3 Shoqëria mund të krijojë filiale, qendra shërbimi, agjensi, degë, zyra përfaqesimi, dyqane dhe çdo organ tjetër të lejuar nga dispozitat ligjore në fuqi edhe në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 5.

#### Regjimi juridik.

- 5.1 Në të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet dhe zbaton me korrektësi legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.2 Të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese të shoqërisë dhe themeluesëve (ortakëve të saj) përcaktohen më hollësisht në Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.
- 5.3 Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.4 Për evidentimin e veprimtarisë, Shoqëria do të përdorë dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit, siç sqarohet më hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë.
- 5.5 Shoqëria gëzon **afirmim ligjor** që nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 5.6 - Administrator dhe përfaqesues ligjor i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët është: **MARIOGLEN XHUMARI**, ortak i Shoqërisë.  
 - Përfaqesues ligjor i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët është: **VILMA ABIB**, ortak i Shoqërisë.  
 - Përfaqesim i vlefshëm është edhe firma e vetem një Administratori.
- 5.7. Administratori dhe përfaqesuesi ligjor i Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe prej **5 (pesë) vjetësh**, duke filluar qysh nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


### Neni 6.

#### Kapitali i Shoqërisë.

- 6.1 Fillimisht, Kapitali themeltar i Shoqërisë është: 1000 ( një mijë )  
 Pjesmarrja e themeluesve ne kapitaline shoqeris është ne perputhje me kontibutet e tyre te meposhtme.
- a) **MARIOGLEN XHUMARI**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 500 leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqeris .
- b) **VILMA ABIB**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 500 leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqeris

#### Kapitali në natyrë:

Krahas ecuresisë së veprimtarisë së shoqërisë, si dhe të mundësive ekonomiko – financiare që do t'i krijohen, kontributet e saj mund të jenë edhe në natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme ose në të drejta të vlerësueshme në para), siç do të vendosë në të ardhmen Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë do të rritet ose do të zvogëlohet në përputhje me ecurinë e veprimtarisë së saj ekonomiko - financiare dhe tregëtare, si dhe të vendimeve që do të marrë në të ardhmën Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

### **Neni 7.**

Organet e drejtimit të shoqërisë

7.1 a) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

b) Administratori (ët) dhe përfaqësuesi(t) ligjorë të shoqërisë.

7.2 Të drejtat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, si dhe të administratorit dhe përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë saktësohen hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

7.3 Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, sipas nevojave që do t'i paraqiten Shoqërisë për drejtimin e veprimtarisë së saj, në të ardhmen do të vendosë edhe për krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për drejtim, si: drejtor, zëvendës-drejtor, etj.

7.4 Për çdo çështje profesionale, si: për çështje juridike, ekonomike, financiare, teknike etj. Shoqëria do të punësojë dhe angazhojë (me kontrate), sipas rastit, juristë, ekonomistë, financierë, teknikë, ekspertë etj. në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

### **Neni 8.**

8.1 Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në institute të tjera shtetërore dhe private ekzistuese dhe ato që mund të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi.

8.2 Masa e pasurisë që do sigurohet, si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga organet drejtuese të Shoqërisë sipas kompetencave që do t'u japë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

### **Neni 9.**

Ndarja e fitimeve.

9.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, si dhe ndaj personave të tretë fizikë dhe juridikë, fitimi neto i Shoqërisë na kalon ne, ortakëve të saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9.2 Me Vendim të Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, fitimi ose një pjesë e tij, mund të investohet për zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Shoqërisë.

### **Neni 10.**

Likujdimi i Shoqërisë.

10.1 Rastet dhe likujdimi i Shoqërisë, si dhe ajo e mbarimit të afatit të Aktit të themelimit të Shoqërsë përcaktohen në Statutin e saj.

10.2 Ky Akt Themelimi (kontrata) për krijimin e Shoqërisë mund të zgjidhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

10.3 Në rastet e likujdimit përfundimtar të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me dispozitat e Statutit të saj, pushon së vepruari edhe Akti i themelimit (kontrata) e krijimit të Shoqërisë.

### **Neni.11.**

#### Dispozita të përgjithshme.

11.1 Ky Akt për themelimin e Shoqërisë (kontrata) ka si pjesë përbërëse të tij edhe Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkëngjitet dhe depozitohet në organet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

11.2 Selia e Shoqërisë është: - Rruga "Mine Peza", Ap. 25, Godina 3/111+4-25 , Zona kadastrale nr .8350, Godina 3 , Hyrja 4 (Nr.14), Tirane, Republika e Shqiperise.

11.3 Çdo ndryshim apo shtesë që mund t'i bëhet këtij Akti për themelimin e Shoqërisë (kontratës) dhe Statutit, duhet të bëhet me shkrim, të nënshkruhet nga ortakët e saj ose përfaqësuesëve të tyre ligjorë dhe të depozitohet si në dokumentet e Shoqërisë që mbahen në selinë e saj, ashtu edhe në organet përkatëse, të detyrueshme me ligj.

### O R T A K E T

#### E SHOQERISE "TROPICAL TRAVEL & TOURS" – SH.P.K.

MARIOGLEN XHUMARI

VILMA ABIB

Marioglen Xhumari

Vilma Abib

